

№. 0301-43

5

1/16

Г

Инд. Бр.

KULTURA QYTETARE



Ky material është përgatitur për arsimtarët që janë të detyruar të realizojnë aktivitetet projektuese nga lëmia e Kulturës qytetare, me qëllim t'iu jepet drejtime se në çfarë mënyre t'i planifikojnë, organizojnë dhe realizojnë këto aktivitete projektuese.

Në të janë hartuar disa mënyra të aspekteve edhe atë:

- * nevoja e vendosjes së aktiviteteve projektuese nga lëmi i kulturës qytetare, në arsimimin e mesëm- gjimnaz;
- * Qëllimet e veçanta dhe të përgjithshme të këtij lloji të aktiviteteve projektuese;
- * lëmi dhe tema të mundshme në kuadër të aktiviteteve projektuese- kultura qytetare;
- * mënyra e organizimit dhe realizimit të aktiviteteve projektuese;

1. NEVOJITET

1. Një nga qëllimet kryesore strategjike që duhet të arrijë arsimit në R. e Maqedonisë është krijimi aktiv i qytetarëve, më saktësisht Ministria e Arsimit dhe Shkencës në dekadën vijuese ka për detyrë që përmes formave të ndryshme të arsimit formal dhe joformal të "krijojë mundësi për inkluzion të pandërprerë social dhe participimi i të rinjëve dhe të rriturve... Do të ndërmer intervenime që të sigurohet se arsimimi do t'i ekipojë të rinjtë me dituri dhe aftësi për qytetërim aktiv".

Aktivitetet projektuese nga lëmi i kulturës qytetare janë në funksion të përmbushjes së këtij qëllimi strategjik në arsim. Nxënësit përmes këtyre aktiviteteve projektuese do t'i marrin vlerat qytetare, do të inkuadrohen në proceset demokratike, do të fitojnë socializëm të domosdoshëm politik.

2. Sot në arsimin, veçanërisht në atë gjimnazor gjatë viteve të fundit intenzivisht bëhen ndryshime në drejtim të përmirësimit të cilësisë së tij dhe sigurimi i diturisë, njohurive afatgjate të nxënësit në funksion të vazhdimësisë së suksesshmetë arsimit në institucionet e larta arsimore si dhe zhvillim sistematik të aftësive sistematike individuale dhe intelektuale (mendim abstrakt, analizim, sistematizim, mësim dhe hulumtim, vlera morale, estetike dhe qytetare).

Njohuria dhe përvoja nga shtetet me zhvillim të lartë të teknologjisë arsimore , udhëzojnë në përfundim se shkolla në të ardhmen duhet të paraqesë laborator për mësim dhe punë aktive të nxënësve. Programi mësimor në të gjitha segmentet e saja duhet të merr formë adekuate të punës humanitare.

Aktivitetet projektuese ofrojnë pikërisht aso forme të punës dhe për këtë arsye ato janë veçanërisht të rëndësishme dhe lejohen në arsimimin gjimnazor.

Nevojat e kuzistimit të aktiviteteve projektuese nga lëmi i kulturës qytetare në arsimimin gjimnazor sqarohet me njohuritë se:

- * nxënësit duhet të përgatiten për pjesëmarrje në përparimin, në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, të marrin shprehje për pjesëmarrje aktive në jetën qytetuese.
- * nxënësit duhet të dijnë se si të vijnë deri te informacionet e nevojshme në zgjidhjen e problemeve në bashkësi, të mund ato t'i selektojnë;
- * të fitojnë shprehje për punë ekipore, të marrin përgjegjësi, të kenë shprehje për bashkëpunim, mirëkuptim të ndërsjellë, tolerancë, respektimi dhe miratimi i vendimeve të përbashkëta;
- * nxënësve e domosdoshme iu është përvoja dhe shkathtësitë praktike që i avancojnë kompetencat dhe efikasiteti gjatë identifikimit dhe zgjidhjes së problemeve në bashkësinë shoqërore që jetojnë;
- * nxënësit duhet t'i njohin hapat në punën hulumtuese, si mundësi e vetme për ndryshime në drejtim të krijimit të mirëqenies në bashkësinë shoqërore;
- * këto njohuri do t'iu ndihmojnë gjatë hartimit të temës së maturës gjatë dhënies së provimit të maturës.

2. QËLLIMET

2.1. Qëllimet e përgjithshme

Aktivitetet projektuese nga lëmi i kulturës qytetare janë vetëm pjesë nga Plani mësimor për arsimimin gjimnazor që kanë për qëllim që t'iu mundësojnë nxënësve, qytetarëve të ardhshëm të Republikës së Maqedonisë, të fitojnë njohuri, aftësi nga lëmi i arsimimit për qytetërim demokratik, veçanërisht atyre që kanë të bëjnë me shoqërinë bashkëkohore, politike, ekonomike dhe kulturore. Ato nuk kanë status të disiplinës shkencore dhe profesionale, por kanë shprehur karakterin praktik, të cilët të nxënësit do të zhvillojnë mendim shkencor dhe metodologji të punës në cilësi për disiplinat përkatëse shkencore, në veçanti ato të krijuara në sociologjinë bashkëkohore.

2.2. Qëllimet konkrete

Aktivitetet projektuese nga lëmi i kulturës qytetare nxënësve do t'iu mundësojë:

- * t'i njohin dhe zbatojnë procedurat dhe metodat gjatë hulumtimit të dukurive shoqërore;
- * të mund të identifikojnë probleme dhe t'iu japin përparësi;
- * të fitojnë përvoja praktike që i përparojnë kompetencat dhe efektshmërinë e tyre;
- * të zhvillojnë shkathtësi për pjesëmarrje aktive në zgjidhjen e problemeve;
- * të ndikojnë ndaj pushtetit gjatë miratimit të vendimeve;
- * të dijnë t'iu mbrojnë të drejtat qytetare;
- * të mësohen se si ta tregojnë mendimin e tyre;
- * të dijnë të hartojnë plan të aktiviteteve;
- * të zhvillojnë shkathtësi për punë në grupe;
- * të dijnë të shfrytëzojnë literaturë dhe informacione për problemin e dhënë;

- * të dijnë të selektojnë informata;
- * të ndërtojnë kulturë në të folurit, të shkruarit dhe të interpretimit;

3. LËMI DHE TEMA

Aktivitetet projektuese të Kulturës qytetare përfshijnë më shumë lëmi, por rekomandohen këto në vijim:

- Demokraci në Republikën e Maqedonisë;
- të drejtat njerëzore;
- të drejtat dhe obligimet qytetare;
- punësia, papunësia, varfëria, migrimi;
- kultura e të jetuarit, stilet e jetës;
- kultura, pluralizëm kulturor;
- jeta sociale- politika sociale;
- vlera, norma, zakone;
- shfrytëzimi i kohës së lirë në mënyrë racionale;
- devijime shoqërore;
- zgjidhja e konflikteve;
- ndikimi i mas-mediave, dhe të rinjtë (televizioni dhe dhuna, mediat e reja elektronike, bota e virtualitetit);
- religjioni në shoqërinë bashkëkohore (lëvizje të reja religjioze);
- keqpërdorimi i fëmijëve;
- planifikimi i fëmijëve;
- tregtia me njerëz;
- qëndrimet dhunuese të të rinjëve;
- keqpërdorimi i fëmijëve në qëllime politike;
- të rinjtë dhe morali;
- barazi mes gjinive;

4. MËNYRA E ORGANIZIMIT DHE REALIZIMIT

Për shkak të specifikës së saj , aktivitetet projektuese dallohen nga lëndët mësimore dhe për këtë arsye planifikohen dhe realizohen në mënyrë të jashtëzakonshme.

Numri i përgjithshëm i orëve i paraparë për aktivitetet projektuese gjatë një viti mësimor arrin 70 orë.

Aktivitetet projektuese nga lëmi i kulturës qytetare realizohen në kuadër të 35 orëve . Prej të cilave 1/3 e kohës duhet shfrytëzuar për planifikimin e aktiviteteve projektuese, kurse koha e mbetur për realizimin e detyrave konkrete: individuale dhe në grupe më të vogla.

Rekomandohet që aktivitetet projektuese të realizohen gjatë njërës gjysmëvjetor me qëllim që të mbahet kontinuiteti, intenziteti dhe motivimi i nxënësve.

Aktivitetet projektuese nga kultura qytetare nxënësit mund t'i realizojnë vetëm në vitin e III dhe IV.

Arsimtarët duhet të përgatisin planifikimin që duhet të jetë në funksion të realizimit të hapave të programit "Ne populli - projekt qytetari", që është i përgatitur nga Qendra për arsimim qytetar nga Kollobasas- Kaliforni, kurse e përshtatur në nevojat dhe kushtet maqedonase. Ajo që është mëse e rëndësishme dhe për të mundur arsimtari ta realizojë këtë program, ai patjetër duhet të përcjellë trajnim përkatës. Për realizim të suksesshëm të programit janë përgatituredhe doracak për arsimtarët dhe nxënësit.

Nxënësit që janë përcaktuar për lëminë e kulturës qytetare duhet të punojnë me ekipe. Njëherësh, ato mund të formojnë grupe prej 4-5 nxënës, që do të hulumtojnë problem të njejtë nga kjo lëmi. Grupi duhet të zgjedhë problem , ta parashihë dinamikën e aktiviteteve projektuese, në pajtim me hapërimet përmes të cilave realizohet programi. Rezultatet nga hulumtimi mund t'i prezentojnë përmes hartimit apo përpilimit të portfolios së përbashkët, por pas kësaj çdo nxënës duhet të përgatitë raport personal për aktivitetet për të cilat ka qenë i detyruar në grupe në pajtim me procedurat e punës hulumtuese.

Programi "Ne populli - projekt qytetari" realizohet përmes gjashtë hapave:

Hapi i parë: identifikimi i problemeve të politikës publike në bashkësi

Hapi i dytë: zgjedhja e problemit që do të zhvillohet- paraqitet;

Hapi i tretë: grumbullimi i informacioneve (të dhënave) për problemin që paraqitet;

Hapi i katërt: hartimi-përpilimi i portfolios;

Hapi i pestë: paraqitja e portfolios;

Hapi i gjashtë: vështrimi i (refleksionit) shkencor

Programi "Ne populli - projekt qytetari" mundëson inkuadrim aktiv të nxënësve në të gjitha fazat e dukurive hulumtuese. Ata kanë mundësi të informohen, ta tregojnë mendimin individual, të propozojnë alternativa, zgjidhje të problemit, të vendosin, të ndërmarrin aksione.

Aktivitetet mund të realizohen në shkollë dhe jashtë saj, në institucione tjera përkatëse.

Gjatë realizimit të programit, nxënësit do të kenë mundësitë zbatojnë metoda interaktive të punës dhe teknika bashkëkohore të mësimin.

Arsimtari është mentor, koordinator i aktiviteteve, jep udhëzim për punë, kontrollon, drejton, e përcjell punën e nxënësve. Çdo aktivitet projektues që e udhëheq nxënësi ose grupë nxënësish duhet ta evidentojë në ditarë të posaçëm për evidentim.

Arsimtari duhet të kujdeset se a janë të përfshirë të gjithë nxënësit në aktivitetin projektues në pajtim me aftësitë dhe interesimin e tyre dhe a posedojnë ata kontrollim në punën e përgjithshme të aktiviteteve projektuese. Dëshmi për punë mirë të realizuar është nënshkrimi i arsimtarit (mentori, i cili e përcjell punën e nxënësve) dhe duhet të qëndrojë në listën evidentuese që e plotëson nxënësi pas çdo aktiviteti të kryer.

Në qoftë se nxënësi gjatë arsimit gjimnazor sërish e zgjedh lëminë e kulturës qytetare , atëherë problemi hulumtues duhet të vendoset në nivel më të lartë , përkatësisht duhet të thellohet pjesa e udhëheqjes së projektit (hulumtime thelluese), kurse nxënësit të drejtohen drejtë hulumtimit të çështjeve më ndërlikuese nga problemi hulumtues.

Për realizimin e aktiviteteve projektuese të kulturës qytetare arsimtarë përkatës është ai që kryer studime të sociologjisë, filozofisë, mbrojtje dhe siguri.